

**Akt themelimi
I SHOQERISE TREGETARE
“KRISTAL 2001” SHPK**

1. HYRJE

- 1.1 Ne mbeshtetje te Nenit 2 , paragrafi i pare , shkronja “b” te Ligjt “per sanksionimin dhe mbrojtjen e prones private , te nismes se lire te veprimtarise private te pavarur dhe privatizimit “ Nr. 7512 date 10.08.1991, dhe te Ligjt qe rregullon pjesen e pare te “Kodit Tregetar” me Nr. 7632 date 4.11.1993, personin fizik : **Sokol Agalliu** , i ditelindjes 17. 04. 1966 , me adresë, lagja 15 Rruga Sytki Cico,Pall.2, Shk.1, Ap. 1 ,Tirane me shtetesi dhe kombesi Shqipetare, me pasaporte Nr.0515862.
Si pale kontraktuese , nepermjet kesaj Akt Themelimi

2 DISPOZITA TE PERGJITHESHME

- 2.1 Ortaku i vetem krijon shoquerine private me mjetet e veta.

3. STRUKTURA BAZE

3.1 Forma

Ortaku i vetem themelon nje shoqeri me perjegjesi te kufizuar ne pajtim me legjislacionin ne fuqi.

3.2 Emri

Veprimtaria e shoqerise do te kryhet nen emrin shoqeria tregetare “Kristal 2001”shpk.

3.3 Afati

Shoqeria do te filloje veprimtarine e saj nga data efektive dhe do te vazhdoje ate per me shume se 10-vjet, nese nuk perfundon me pare sipas menyrate te parashikuara ne ligj.

3.4 Objekti

Objekti i veprimtarise pershkruhet ne pikën 2 te Statutit te shoqerise qe i bashkengjitet kesaj kontrate dhe se bashku perbejne aktet themelore te shoqerise.

3.5 Qellimi i per gjithshem


Qellimi per te cilen shoqeria organizohet eshte realizimi i objektivave qe pershkuhen ne statut.

PERCAKTI

Ne kete akt themelimi dhe ne statut ,ne se nuk bihen ne kundershtim me kontekstin fjalet dhe shprehjet te kene keto kuptime:

4.1 Data efektive

Date efektive do te nenkuptohet data e rregjistrimit te shoqerise ne rregjistrin tregetar te Gjykates se Tiranes.

4.2 Material Konfidential

Me termin material konfidential do te kuptojme te gjitha informacionet qe shkembehen ose qe mund te shkembehen ndermjet paleve ne te shkruar ,te printuar ,te fotografuar ose te medias elektronike panvarsisht nga forma e komunikimit.

MARVESHJA FINANCIARE

5.1 Kapitali themeltar i ortakut te vetem

Ortaku i vetem ka kapitalin themeltar sipas percaktimit ne statutin e shoqerise.

5.2 Shperndarja


Shperndarja e fitimit neto do te behet ne kohen kur ortaku i vetem do te vendose ne menyre te arsyeshme.

MBARIMI

Ne rast se per cdo arsye shoqeria mbaron , do te behet nje llogari e per gjitheshme , e plete dhe e menjehershme e aktivit dhe pasivit.
Pasurite e saj do te shiten "cash" sa me shpejt te jete e mundur dhe te gjitha huate dhe shumat e tjera te shoqerise do te mblidhen.

Tirane me 2001

**ORTAKU I VETEM
SOKOL AGALLIU**



**STATUTI
I SHOQERISE TREGETARE
“KRISTAL 2001” SHPK**

1. **HYRJE**

1.1 **Palet**

Shoqeria tregetare me perjegjesi te kufizuar: "Kristal 2001"shpk,krijohet mbi bazen e iniciativae dhe kapitalit te ortakut te vetem:
Sokol Agalliu, i datelindjes 17.04.1966, lindur ne Kucove me banim ne Tirane, lagjia 15, rruga Sytki Cico, P.2, Shk.1 ,Ap.1 , madhor, me zotesi te plete juridike per te vepruar, me kombesi dhe shtetesi shqiptare, mbajtes i pashaportes me nr.0515862.

1.2 **Baza ligjore**

- 1.2.1 Shoqeria krijohet dhe zhvillon veprimtarine e saj ne pajtim me irregullat e ketij statuti , te kontrates dhe te legjislacionit ne fuqi te Republikes se Shqiperise.
- 1.2.2 Kjo shoqeri , si shoqeri me perjegjesi te kufizuar i perballon humbjet deri ne kufirin e kapitalit themeltar.

2 **OBJEKTI**

Shoqeria Tregetare “Kristal 2001”shpk do te kete si objekt te veprimtarise se saj:

- 2.1 Import - eksportin dhe tregtimin me shumice dhe pakice te te gjithe llojeve te mallrave ,si prodhime industriale, bujqesore ,blektorale,lende te pare per industrine ushqimore , duhane , pije alkoolike , aparatura elektronike, pjese kembimi per makineri te ndryshme , materiale ndertimi, do te ushtroje cdo aktivitet ne sektore te tjere industrial, ne vecanti , prodhime ne fushen e industrise mekanike , te industrise ushqimore , prodhime dhe shitje veshje dhe konfeksione te cdo natyre , galerante dhe ne fusha te tjera per mallra konsumi , ne pershtatje me nevojat e tregut te brendeshem dhe te huaj.
- 2.2 Riparim dhe prodhimi i aparaturave elektromekanike.
- 2.3 Industrine e perpunimit.

2.4 Gjuetine dhe peshkimin .

2.5 Aktivitetet turistike.



EMRI, SELIA , TERRITORI

Emri i kesaj shoqerie do te jete : "Kristal 2001" shpk.

Shoqeria fiton personalitetin e saj juridik nga data e regjistrimit te saj ne regjistrin tregetar te Gjykates te Rrethit Tirane.

3.2 Shoqeri e ka qendren e saj ne qytetin e Tiranes, ne lagjen 15 , rruga Sytki Cico,P. 2, Shk.1, Ap.1 dhe mund te zhvilloje veprimtarine e saj ne te gjithe teritorin e Republikes se Shqiperise si dhe jashte saj.

3.3 Ajo mund te krijoje filiale ose perfaqesi dhe ne rrethe te tjera te Republikes se Shqiperise ose jashte saj.

KAPITALI THEMELTAR I SHOQERISE

4.1 Kapitali themeltar I shoqerise perbehet nga kontributi i ortakut te vetem ne shumen 100.000 leke.

4.2 Nenshkrimi i statutit nga ortaku i vetem verteton shlyerjen e kapitalit themeltar

4.3 Kapitali themeltar mund te zmadhohet ose zvogelohet ne vartesi te rezultateve dhe ne perputhje me legjisacionin ne fuqi.

4.4 Kapitali themeltar mund te transferohet jashte shoqerise tek persona te tjere qe nuk bejne pjese ne shoqeri, ose te lihet peng ne perputhje me legjisacionin ne fuqi.

4.5 Shoqeria mund te kete edhe kontribute ne natyre.Ne kontribute ne natyre perfshihen te gjitha pasurit e paluajteshme si dhe cdo lloj makinerie e paisje qe behet prone e shoqerise.

5 FONDET E SHOQERISE

- 5.1 Shoqeria percakton fondet e me poshteme :
- 1.Fondin themelor (qarkullues)
 - 2.Fondi rezerve
 - 3.Fonde te tjera , te cilat mund te jene te nevojshme gjate veprimtarise.
- 5.2 Masa e secilit fond dhe menyra e perdorimit te tij percaktohen me vendim te organit drejtues te shoqerise dhe ne perputhje me legjislacionin ne fuqi.
- ## **6 ORGANI DREJTUES DHE ADMINISTRIMI I SHOQERISE**
- 6.1 Shoqeria “KRISTAL 2001”, zhvillon veprimtarine e vet ne perputhje me kete kontrate , statutin e saj dhe me legjislacionin Shqiptar .
Ortaku i vetem i shoqerise drejton veprimtarine duke u mbeshtetur ne te drejten e pronesise private , ne mjetet e investuara ne shoqeri.
- 6.2 Shoqeria “Kristal 2001” do te drejtohet nga ortaku i vetem i cili do te vetequhet Administratori i shoqerise.
- 6.3 Administratori i shoqerise ka te drejte te merret me te gjithe veprimtarine e shoqerise , te marre ne pune persona te ndryshem me kontrate te rregullt.
- ## **7. KOPETENCAT E ADMINISTRATORIT**
- 7.1 Realizon marredheniet e ndryshme ekonomike me persona te tjere fizik dhe juridik.
- 7.2 Aprovon rregullat per sektore te ndryshem te veprimtarise se shoqerise.
- 7.3 Shqyrton bilancin, fondet si dhe fitimin.
- 7.4 Kujdeset per ndjekjen e problemeve te shoqerise me organet e ndryshme

Shteterore si dhe me persona te tjere fizike dhe juridik.



7.5 Kujdeset per funksionimin e perditshem dhe normal te shoqerise ,kordinon Veprimtarine e tij me stafin e shoqerise.

MENYRA E PERFAQESIMIT

- 8.1 Shoqeria perfaqeshet nga administratori i vetem ne te gjitha mardheniet juridike civile me persona te tjere fizik dhe juridik si dhe me organet e ndryshme shteterore. Shoqeria mund te perfaqeshet edhe nga persona te tjere te paisur me autorizim te vecante te nenshkruar nga administratori.

FITIMI

- 9.1 Shoqeri krijon fitimin e saj me ushtrimin e veprimtarise ,ku ky fitim percaktohet nga bilanci vjetor.
- 9.2 Pas perballimit te detyrimeve , taksave , tatimeve , pagave , shpenzimeve te ndryshme mbetet ne dispozicion fitimi neto.
- 9.3 Fitimi neto mund te perdoret per rritjen e kapitalit themeltar me kontributet ne natyre , per zmadhimin e fondeve te shoqerise dhe per qellime te tjera ne pajtim me legjislacionin ne fuqi.

KOHEZGJATJA E SHOQERISE


- 10.1 Shoqeria krijohet per nje periudhe prej mbi 10-vjetesh.

MARDHENIET E PUNESIMIT

- 11.1 Cdo person do te punesohet ne shoqeri mbi bazen e kontrates se punes te lidhur ndermjet tij dhe administratorit , ne perputhje me legjislacionin e punes ne fuqi.

PERGJEGJESIA E PUNONJESVE

- 12.1 Cdo person i punesar ne shoqeri eshte personalisht perqiegjes per kryerjen e detyres. Ai eshte i detyruar te permbush detyrimet qe rrjedhin nga kontrata e punes dhe vendimit te administratorit.Per shkeljet e ndryshme prej te



cilave shoqerise mund ti shkaktohen deme , ndaj cdo te punesuari mund te merren masa te ndryshme deri ne largimin nga puna ne perputhje me legjislacionin e punes ne fuqi.

KONFIDENCIALITETI

Administratori si dhe gjithe personat qe do te perbejne personelin e shoqerise jane te detyruar te ruajne karakterin e fshehte te dokumentacionit , informacionit te njojurive dhe pervojes se shkembyer , si dhe cdo lloji materiali tjeter konfidential dhe duhet te adoptoje te gjithe masat e nevojshme per te parandaluar perhapjen e tyre qofte dhe pjeserisht.

14 MOSMARVESHJET

- 14.1 Mosmarveshjet eventuale qe mund te lindin nderinjet ortakut te vetem dhe personave te tjere fizik dhe juridik shqiptare apo te huaj do te zgjidhen sipas Legjislacionit shqiptar.Kopetente per zgjidhjen e tyre do te jete Gjykata e Tiranes.

15 MBARIMI I SHOQERISE

- 15.1 Veprimtaria e shoqerise mbaron me vendim te organit drejtues te saj nese aktiviteti i saj nuk rezulton fitimprures si dhe per cdo shkak tjetër te parashikuar ne ligj.

16 DISPOZITAT E FUNDIT

- 16.1 Shoqeri fiton zotesine per te vepruar me rregistrimin ne Gjykaten e rrithit te Tiranes dje pas paisjes me license nga Zyra e Tatim Taksave te rajonit nr.1 Tirane.

- 16.2 Shoqeria ka vulen e saj , forma dhe madhesia e te ciles percaktohet nga administratori i shoqerise .

- 16.3 Kjo kontrate mbahet ne kater kopje originale nga te cilat dy i mban shoqeria, nje kopje depozitohet ne Gjykate , dhe nje e mban noteri Lejohet shumefishimi vetem per efekt te procedures se legalizimit dhe te zhvillimit te veprimtarise se shoqerise.

Kjo kontrate hyn ne fuqi dhe quhet e lidhur diten e nenshkrimit nga ortaku i vetem.

Tirane , me.....2001.

ORTKU I VETEM

SOKOL AGALLIU